



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/98

Datë: 18.04.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, nenit 29 të Ligjit 03/L-48 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë me ndryshimet dhe plotësimet e bëra, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 prill 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në shumë prej 20,000 euro me qëllim të shprehjes së solidaritetit dhe përkrahjes për rindërtimin e katedrales Notre-Dame në Paris, pas dëmeve të shkaktuara nga zjarri.
2. Mjetet nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nën programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100 kategoria e Shpenzimeve të Rezervës dhe transferohen në Ministrinë e Financave në nën programin Thesari me kod 201-11200 në kategorinë e shpenzimeve subvencione dhe transfere.
3. Obligohet Ministria e Financave për zbatimin këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/98

Datë: 18.04.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 prill 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Plotësohet dhe ndryshohet pika 3. e Vendimit të Qeverisë Nr. 02/80, datë 18.12.2018 dhe pika 3. e Vendimit të Qeverisë Nr. 05/83, datë 11.01.2019, si në vijim:
 3. Përbërja:
 - 3.1. Koordinatori Nacional për Integrim dhe Anëtarësim në NATO, z. Burim Ramadani – kryesues;
 - 3.2. Këshilltar i Kryeministrit – zëvendëskryesues;
 - 3.3. Ministri i Punëve të Jashtme – anëtar;
 - 3.4. Ministri i Mbrojtjes – anëtar;
 - 3.5. Ministri i Drejtësisë – anëtar;
 - 3.6. Ministri i Punëve të Brendshme – anëtar;
 - 3.7. Ministri i Integritimit Evropian – anëtar;
 - 3.8. Ministri i Financave – anëtar;
 - 3.9. Ministri i Infrastrukturës – anëtar;
 - 3.10. Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës – anëtar.
2. Pikat tjera të Vendimit Nr. 02/80, datë 18.12.2018 dhe Vendimit Nr. 05/83, datë 11.01.2019 mbesin të pandryshuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/98

Datë: 18.04.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 prill 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Për emërimin e zëvendësministrit të Mbrojtjes, z. Burim Ramadani, si Koordinator Nacional për Integrim dhe Anëtarësim në NATO.

A R S Y E T I M

Duke marrë parasysh prioritetin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për përafrim, integrim dhe anëtarësim në NATO, pas miratimit të ligjeve për mandatimin ushtarak të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK) dhe themelimit të Ministrisë së Mbrojtjes;


Duke marrë parasysh nevojën për intensifikimin e aktiviteteve dhe qasjes nacionale për thellimin e komunikimit me strukturat politike e ushtarake të NATO-s, si dhe vendeve anëtare të NATO-s;

Koordinatori Nacional për Integrim dhe Anëtarësim në NATO do të udhëheq Komitetin ndër-ministror, në qasjen strategjike të politikave dhe komunikimit të Republikës së Kosovës me NATO-n.

2. Detyrat dhe Përgjegjësitë e Koordinatorit Nacional për Integrim dhe Anëtarësim në NATO:
 - 2.1. Udhëheq punën në hartimin e platformës nacionale të politikave të integritimit në NATO dhe në sigurimin e resurseve përkatëse;
 - 2.2. Udhëheq dhe ndjek ecurinë e këtij procesi dhe t'i paraqesë Qeverisë së Republikës së Kosovës, për miratim, dokumente strategjike dhe plane veprimi, në baza periodike;
 - 2.3. Udhëheq komunikimin në emër të Republikës së Kosovës, sipas koordinimit me Kryeministrin e Kosovës, në raport me NATO-n dhe faktorin ndërkombëtar prezent në Kosovë që ndërlidhet me NATO-n apo shtetet anëtare të NATO-s;

- 2.4. Koordinatorin Nacional për Integrim dhe Anëtarësim në NATO funksionon nën mbikëqyrjen direkte të Kryeministrit dhe themelon Grupin e Ekspertëve nga institucionet publike, shoqëria civile dhe ekspertë të pavarur vendorë e ndërkombëtarë, si dhe Sekretariatit Administrativ, me qëllim që të studiojë alternativat dhe rrugëzgjdhjet për integrimin e Kosovës në NATO;
- 2.5. Koordinatorin Nacional për Integrim dhe Anëtarësim në NATO mund të emërojë deri në tre (3) këshilltarë për të ndihmuar në zbatimin e termave të referencës.
3. Paga e Koordinatorit Nacional për Integrim dhe Anëtarësim në NATO do të jetë e barazvlefshme me pagën e Ministrit.
4. Obligohet Zyra e Kryeministrit dhe Ministria e Financave për mbështetje buxhetore të Koordinatorit Nacional për Integrim dhe Anëtarësim në NATO.
5. Obligohet Ministria e Mbrojtjes që të zbatojë aspektin administrativ të vendimit për Koordinatorin Nacional për Integrim dhe Anëtarësim në NATO dhe zyrës së tij.
6. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 04/98
Datë: 18.04.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, bazuar në Ligjin e Buxhetit nr 06/L-133 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, Neni 15 paragrafi 2, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 prill 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për miratimin e buxhetit në vlerë 471,484 euro, për zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar komune në komunat Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Ministria e Financave me kod 201, nën programi Kontigjencat me kod 28900 nga kategoria e shpenzimeve mallra dhe shërbime, dhe transferohen në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve me kod 320, në nën-programin Sekretariati me kod 14100, shuma prej 81,053 euro në kategorinë e shpenzimeve paga dhe mëditje dhe në nën-programin Zgjedhjet me kod 14200, shuma prej 390,431 euro në kategorinë e shpenzimeve mallra dhe shërbime.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/98

Datë: 18.04.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, bazuar në Ligjin e Buxhetit nr 06/L-133 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019, Neni 15 paragrafi 2, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 prill 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa për aprovimin e buxhetit shtesë në vlerë 18,618,18 euro, për angazhime shtesë gjatë dhe pas orarit të punës për kryesuesen dhe anëtarët e PZAP-it si dhe zyrtarët e sekretariatit të PZAP, lidhur me zgjedhjet jashtëzakonshme për kryetar komune në komunat; Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan.
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi ndahen nga Ministria e Financave me kod 201, nën programi Kontigjencat me kod 28900 nga kategoria e shpenzimeve mallra dhe shërbime dhe transferohen në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa me kod 247 nën programi kodi 25700, në kategorinë e shpenzimeve paga dhe mëditje.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/98

Datë: 18.04.2019


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 11 dhe 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, duke shqyrtuar kërkesën e MMPH-së, nr. prot. 1205/19 datë 06.03.2019, në mbledhjen e mbajtur më 18 prill 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M P Ë R F U N D I M T A R

1. Miratohet shpronësimi për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i Projektit të infrastrukturës "Zgjerimi i Rrugës Nacionale N25.2 Hyrja në Gjilan", me gjatësi L=3km, ZK Gjilan dhe Livoç i Epërm, Komuna Gjilan dhe ZK Koretishtë, Komuna Novobërdë, sipas tabelave pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit i punuar nga Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme/Ministria e Financave dhe tabelat pjesë përbërëse e këtij vendimi, në të cilat është përcaktuar shuma e kompensimit për ata pronarë apo zotërues interesi, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve iu janë prekur nga procesi i shpronësimit, sipas tabelave të vlerësimit në "Shkresë përcjellëse e Aktit të Vlerësimit" Nr. Protokolli 3776/18 datë 26.06.2018.
3. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH, i dërgon vendimin subjektivit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat pjesë përbërëse e këtij vendimi.
4. Brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
5. Kundër këtij vendimi subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit në pronën e paluajtshme ose të drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat pjesë përbërëse e këtij vendimi, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditëve kalendarike kanë të drejtë për të ushtruar ankesë pranë gjykatës kompetente vetëm sa i përket lartësisë së shumës së kompensimit të përcaktuar me këtë vendim.
6. Brenda pesë (5) ditëve kalendarike pas dorëzimit të ankesës në gjykatën kompetente parashtruesi i ankesës duhet të sigurojë që pesë (5) kopje të ankesës të dorëzohen fizikisht në Zyrat e Avokaturës Shtetërore/Ministria e Drejtësisë dhe një (1) kopje të ankesës në Zyrat e Departamentit të Shpronësimit.

7. Brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, Departamenti i Shpronësimit në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar në këtë vendim.
8. Ky vendim bashkë me pjesët tabelare dhe grafike të tij paraqet bazë juridike për regjistrim në librat kadastral në emër të titullarëve të rinj si dhe ndarjeve teknike të parcelave kadastrale. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, zyra kadastrale është e obliguar të kryej veprimet procedurale dhe teknike për zbatimin e tij.
9. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Ramush HARADINAJ



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/98


Datë: 18.04.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4, 8, 44 dhe nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin Nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 prill 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M P R E L I M I N A R

1. Miratohet shpronësimi i përhershëm dhe krijimi i së të drejtës së servitutit të detyrueshëm për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga realizimi i Projektit: "Ndërtimi i Parkut të Energjisë me Erë Selac" që përfshin ndërtimin e largpërçuesit 110kV, Nën stacioni Vushtrria 1-Nën stacioni Selac dhe nënstationi 33/110kV Selac zonat kadastrale: Vushtri, Dobërllukë, Banjë, Gjëlbrishtë Sumë, Gumnishtë, Komuna e Vushtrrisë dhe zonat kadastrale Rashanë, Tërstenë, Bajgorë, Komuna e Mitrovicës, sipas tabelave të përshkruar nga evidencat kadastrale përkatëse për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitën e tyre në kuadër të projektit të interesit publik si dhe sipërfaqeve të tyre, të cilat tabela janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Obligohet Departamenti i Shpronësimit/MMPH që brenda 5 (pesë) ditëve të punës, pas nënshkrimit të këtij vendimi preliminar, t'i njoftojë pronarët dhe pretenduesit e tokave të cilat do të shpronësohen dhe brenda afatit prej 10 ditëve të punës pas miratimit të njëjtin ta shpallë në Gazetën Zyrtare të Kosovës, si dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.
3. Kundër këtij vendimi apo cilës do pjesë të tij kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve kalendarike në Gjykatën Kompetente, subjekti kërkues dhe cili do person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme të prekur nga ky vendim.
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Departamenti i Shpronësimit (MMPH), Ministria e Financave dhe Ndërmarrja Publike Qendrore KOSTT (Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut Sh.A).
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Ramush HARADINAJ


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/98
Datë: 18.04.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. të nenit 93 paragrafi (4) dhe të nenit 17 paragrafi 1. të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 prill 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma e Ministrisë së Financave për negocimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për Bashkëpunimin në Mbështetje të Themelimit të Njesisë Qendrore për Mbështetje të Projekteve Infrastrukturore.
2. Përgjatë negocimit të kësaj marrëveshjeje, Ministria e Financave obligohet të procedojë konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave tjera ligjore në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/98


Datë: 18.04.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 7 paragrafi 5. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.15/2017, me Rregulloren Nr.16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 prill 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Financave për të kërkuar nga Presidenti i Republikës së Kosovës dhënie e autorizimit Ministrit të Financave për nënshkrimin e Marrëveshjes së Kredisë mes Republikës së Kosovës, e përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), për financimin e projektit për Trajtimin e Ujërave të Zeza në Komunën e Gjilanit.
2. Qeveria e Republikës së Kosovës i rekomandon Presidentit të Republikës së Kosovës dhënie e autorizimit Ministrit të Financave për nënshkrimin e Marrëveshjes nga pika 1. e këtij vendimi, në përputhje me Ligjin për Marrëveshjet Ndërkombëtare.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr.10/98
Datë: 18.04.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 shtojcën 11 pika iii. të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 dhe 50 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 prill 2019, nxjerr këtë:


V E N D I M

Për themelimin e strukturave për zbatimin e pakos ligjore për administratën publike

1. Strukturat për zbatimin e pakos ligjore për administratë publike janë;
 - 1.1. Struktura politike me këtë përbërje:
 - 1.1.1. Ministri përgjegjës për administratë publike;
 - 1.1.2. Ministri përgjegjës për financa, dhe
 - 1.1.3. Koordinatorin nacional për reforma shtetërore.
 - 1.2. Komisioni Ekzekutiv me këtë përbërje:
 - 1.2.1. Erna Hasangjekaj, drejtor i DMRAPIE/MAP;
 - 1.2.2. Naser Shamolli, drejtor i DL/MAP;
 - 1.2.3. Arben Krasniqi, drejtor i SKQ/ZKM;
 - 1.2.4. Tefik Mahmuti, drejtor i DASHC/MAP;
 - 1.2.5. Salvador Elmazi, drejtor i DB/MF;
 - 1.2.6. Ahmet Ismajli, drejtor i THESARIT/MF;
 - 1.2.7. Mentor Borovci, drejtor i ZL/ZKM;
 - 1.2.8. Arjeta Sahiti, udhëheqëse e DKP/ZKM dhe
 - 1.2.9. Bekim Demiri, Administrator i SIMBNJ/MAP.
2. Komisioni Ekzekutiv ka këto detyra:
 - 2.1. hartimin e akteve nënligjore të cilat burojnë nga pakoja ligjore e Administratës Publike;
 - 2.2. siguron zbatimin e klasifikimit të vendeve të punës të zyrtarëve publikë aty ku aplikohet sistemi i klasave;
 - 2.3. kujdeset që organizimi i brendshëm i institucioneve të bëhet në pajtim me rregullat e reja;
 - 2.4. azhurnimin, përshtatjen dhe ndërlidhjen e sistemeve elektronike për burimet njerëzore me sistemin elektronik të pagave në një sistem të vetëm unik;

- 2.5. popullimin me të dhëna dhe funksionalizimin e SIMBNJ;
 - 2.6. siguron që pagat e reja të realizohen në pajtim me rregullat e reja;
 - 2.7. vendosjen e sistemit të ri të rekrutimit në praktikë;
 - 2.8. çdo detyrë tjetër që del si obligim nga pakoja ligjore e administratës publike.
3. Për realizimin e detyrave nga neni 2 anëtarët e komisionit ekzekutiv propozojnë grupe të punës të cilat themelohen nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Administratës Publike.
 4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 11/98
Datë: 18.04.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 prill 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për plotësim ndryshimin e Ligjit Nr. 04/L-088 për Arkivat Shtetërore.
2. Obligohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/98
Datë: 18.04.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 prill 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Grupi Punues për të shqyrtuar mungesën e kuadrove dhe të ardhmen e drejtimit elektro energjetik në Universitetin e Prishtinës, në përbërje të përfaqësuesve nga:
 - 1.1. Ministria e Zhvillimit Ekonomik – kryesues;
 - 1.2. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë – një anëtar;
 - 1.3. Rektorati i Universitetit të Prishtinës – një anëtar;
 - 1.4. Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (FIEK) – një anëtar;
 - 1.5. Këshilli Shtetëror për Cilësi – një anëtar;
 - 1.6. KOSTT – një anëtar;
 - 1.7. KEK – një anëtar;
 - 1.8. ZRRE – një anëtar;
 - 1.9. Shoqëria Civile – një anëtar.
2. Grupi Punues ka për detyrë të shqyrtojë çështjen e mungesës së kuadrove dhe të ardhmen e drejtimit elektro energjetik, në kuadër të Universitetit të Prishtinës, dhe të dalë me propozime konkrete për zgjidhje të problemit.
3. Obligohen ministritë e linjës dhe institucionet tjera përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/98

Datë: 18.04.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 prill 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Qendra për Ekselencë Dixhitale në kuadër të Parkut të Inovacionit dhe Trajnimit (ITP) në Prizren.
2. Themelimi i Qendrës për Ekselencë Dixhitale (QED) sipas pikës 1. të këtij vendimi ka të bëjë me:
 - 2.1. krijimin e ekosistemit të përshtatshëm që idetë kreative të shndërrohen në gjenerator të krijimit të vendeve të reja të punës dhe rritjes së eksporteve në ekonominë dixhitale;
 - 2.2. ngritjen e kapaciteteve njerëzore për të adresuar sfidat e transformimit teknologjik;
 - 2.3. krijimin e ambientit mundësues për hulumtimin dhe zhvillim të organeve qeveritare, akademisë dhe sektorit privat.
3. Obligohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për funksionalizimin e Qendrës për Ekselencë Dixhitale.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 14/98

Datë: 18.04.2019

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 15/2017, me Rregulloren Nr. 16/2017, me Rregulloren Nr. 07/2018, me Rregulloren Nr. 26/2018 dhe me Rregulloren Nr. 30/2018, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 18 prill 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet kërkesa e Ministrisë së Mbrojtjes për marrjen në shfrytëzim në kohë të pacaktuar të Aeroportit Civil të Gjakovës, për nevojat strategjike të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës.
2. Obligohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Ministria e Mbrojtjes që të emërojnë Komisione Pune për vlerësimin dhe regjistrimin e pajisjeve brenda hapësirave të Aeroportit, kompletimin e dokumentacionit përkatës dhe përcjelljen dhe kryerjen e të gjitha procedurave deri në praninë - dorëzimin e Aeroportit.
3. Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Ministri i Mbrojtjes dhe Komisioni Ndërmintor për Ndërmarrje Publike të raportojnë për zbatimin e këtij vendimi dhe të sjellin rekomandime në rast se kërkohet vendimmarrje e Qeverisë.
4. Ministria e Zhvillimit Ekonomik, në pajtim me legjislacionin në fuqi ndërmerr të gjitha veprimet për mbylljen e ndërmarrjes publike qendrore Aeroporti i Gjakovës sh.a, i themeluar me Vendimin e Qeverisë nr. 06/180, të datës 28.03.2014.
5. Shfuqizohet Vendimi i Qeverisë Nr. 06/180, i datës 28.03.2014, Vendimi i Qeverisë nr.04/48, i datës 09.09.2015 dhe Vendimi i Qeverisë Nr. 07/65, i datës 13.09.2018.
6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Ramush HARADINAJ

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë